

VENDIM
Nr. 486, datë 16.7.2014

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE, PËR LUFTIMIN E KARKALECIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, t’i shtohet fondi 8 000 000 (tetë milionë) lekë, për luftimin e karkalecit.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
 3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

